



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Ministartstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja

Komuna e Gjakovës

Municipality of Gjakova

Opština Đakovica

Prishtinë, 16/03/2021

Duke u bazuar në nenet 3, 6, 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 7, 01 mars 2019, Prishtinë), nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 2 të Rregullores nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (08.06.2020), nenet 5 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28, 04 qershor 2008, Prishtinë), si dhe Ligjin Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, lidhet kjo:

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTTI "NDËRTIMI DHE REHABILITIMI I SISTEMEVE TË UJITJES NË KOSOVË, KOMUNA GJAKOVË"

Palët nënshkruese

1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (në tekstin e mëtejme Ministria), e përfaqësuar nga Ministri;

dhe

2. Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme Komuna), e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është bashkëfinancimi i projektit "Ndërtimi dhe rehabilitimi i sistemeve të ujitjes në Kosovë, Komuna Gjakovë", si dhe përcaktimi i obligimeve të Ministrisë dhe Komunës për realizmin e projektit në fjalë.

Neni 2

Vlera e projektit

1. Ministria dhe Komuna do të bashkëfinancojnë projektin “Ndërtimi dhe rehabilitimi i sistemeve të ujitjes në Kosovë, Komuna Gjakovë”, brenda mundësive buxhetore të parapara në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASh) 2021-2023.
2. Vlera e parashikuar e investimit është 302.578,17 euro (treqind e dymijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë euro e shtatëmbëdhjetë cent) dhe financimi i projektit do të bëhet nga buxheti i vitit 2021, 2022 dhe 2023, me pjesëmarrje të financimit prej 90% nga Ministria dhe 10% nga Komuna.
3. Vlera e saktë përfundimtare e projektit (investimit) do të përcaktohet në kontratën e lidhur në mes të Komunës dhe operatorit ekonomik të përzgjedhur sipas procedurave të legjislacionit në fuqi ku vlen njësoj pjesëmarrja e financimit prej 90% nga Ministria dhe 10% nga Komuna.

Neni 3

Përgjegjësitë e Ministrisë

1. Ministria do të ndajë mjetet financiare në shumën e përgjithshme prej 90% të shumës totale të projektit nga neni 1 i kësaj Marrëveshjeje.
2. Mjetet financiare të ndara nga paragrafi 1 i këtij neni ndahen nga Kodi i Programit 40100 Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve, me Kod të Projektit 18863, i ndarë në tri (3) periudha dhe atë si në vijim:
 - 2.1. Nga buxheti i vitit 2021 është paraparë të ndahen 42.320,35 euro (katërdhjetë e dymijë e treqind e njëzetë euro e tridhjetë e pesë cent);
 - 2.2. Nga buxheti i vitit 2022 është paraparë të ndahen 115.000,00 euro (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë euro); dhe
 - 2.3. Nga buxheti i vitit 2023 është paraparë të ndahen 115.000,00 euro (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë euro). Vlera totale e mbështetjes financiare të projektit për periudhën tri (3) vjeçare 2021-2023 është 272.320,35 (dyqind e shtatëdhjetë e dymijë e treqind e njëzetë euro e tridhjetë e pesë cent).
3. Pagesat për periudhën e kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, sipas participimit të Ministrisë, do t'i bëhen operatorit ekonomik sipas kontratës, i cili do të përzgjidhet sipas procedurave të prokurimit nga ana e Komunës.
4. Pagesat bëhen vetëm për aktivitetet e përfunduara në bazë të situacioneve të sjella nga operatori ekonomik, të vërtetuara nga organi mbikëqyrës/menaxheri dhe të verifikuara nga mbikëqyrësi i projektit i emëruar nga Ministria.
5. Pagesat bëhen vetëm për aktivitetet e projektit në fjalë dhe jo për ndonjë aktivitet tjetër.
6. Ministria, në cilësinë e vëzhgueses do të marrë pjesë në vlerësimin e ofertave për zgjedhjen e kontraktuesit dhe në rast që vërehet ndonjë parregullsi, është e obliguar të raportojë tek institucioni përgjegjës.

Neni 4 **Përgjegjësitë e Komunës**

1. Komuna do të udhëheqë projektin, procedurat e prokurimit dhe do të nënshkruajë kontratën në pajtim me legjislacionin përkatës të prokurimit publik dhe menaxhimit të financave publike.
2. Komuna do të ndajë mjetet financiare në shumën e përgjithshme prej 10% të shumës totale të projektit nga neni 1 i kësaj Marrëveshjeje, në vlerë totale të mbështetjes financiare të projektit në shumë prej 30.257,82 (tridhjetëmijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë euro e tetëdhjetë e dy cent), i ndarë në tri (3) periudha dhe atë si në vijim:
 - 2.1. Nga buxheti i vitit 2021 është paraparë të ndahen 10.085,94 Euro (dhjetëmijë e tetëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e katër cent);
 - 2.2. Nga buxheti i vitit 2022 është paraparë të ndahen 10.085,94 Euro (dhjetëmijë e tetëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e katër cent); dhe
 - 2.3. Nga buxheti i vitit 2023 është paraparë të ndahen 10.085,94 Euro (dhjetëmijë e tetëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e katër cent).
3. Finalizimi i kontratës në mes të Komunës dhe operatorit ekonomik të kontraktuar do të bazohet në procesin e vlerësimit përfundimtar tekniko-financiar, në të cilin Ministria do të jetë pjesëmarrëse në cilësinë e vëzhgueses, me të drejtat e saja si palë në bashkëfinancim.
4. Komuna para fillimit të punimeve duhet të dorëzojë në Ministri projektin kryesor të ekzekutimit të punimeve sipas kontratës.
5. Komuna në intervale të rregullta kohore dhe në raste tjera, kur kjo është e domosdoshme do t'i dërgoj Ministrisë këto të dhëna:
 - 5.1. Kopjet e kontratës;
 - 5.2. Kopjet e raporteve të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së punimeve;
 - 5.3. Raportet për përmbushjen e kontratës;
 - 5.4. Detajet e pagesave të bëra sipas kontratës;
 - 5.5. Dokumente tjera sipas kërkesës.
6. Komuna merr për obligim shmangien e pengesave eventuale juridike-pronësore.

Neni 5 **Përgjegjësitë dhe zotimet e përbashkëta**

1. Komuna ka autoritetin dhe përgjegjësinë të lidhë kontratën me operatorin ekonomik, i cili është vlerësuar si më i përgjegjshmi teknikisht dhe financiarisht dhe të emërojë/përzgjedhë menaxherin/mbikëqyrësin, i cili do të menaxhojë realizimin e projektit.
2. Ministria do të emërojë mbikëqyrësin për monitorim të punimeve për realizim të kontratës, me kompetenca të plota për ndërhyrje në rast që konstaton së punimet nuk janë në përputhshmëri me kontratën.
3. Mbikëqyrësi i emëruar/përzgjedhur nga Ministria do t'i raportojë Autoritetit nga i cili është emëruar.

Neni 6
Shqetësimet shtesë të ngritura nga palët

Në rast të keqpërdorimeve eventuale, të cilat rrezikojnë udhëheqjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve që nevojiten për zhvillimin dhe konkurrencën e drejtë dhe të hapur të bazuar në çmim dhe cilësi, palët zotohen se do të bëjnë njoftim zyrtar te organet përgjegjëse.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të bëjnë përpjekje për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale që mund të kenë ndërmjet veti, përmes mirëbesimit ose negociatave miqësore. Ndonjë konflikt apo kërkesë e cila vjen si interpretim i marrëveshjes duke përfshirë esencën e saj, vlefshmërinë apo përfundimin e saj duhet të zgjidhet nga gjykata kompetente.

Neni 8
Amendamentet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim me pëlqimin e dyanshëm të nënshkruesve të marrëveshjes.

Neni 9
Përfundimi

Palët mund të shkëpusin Marrëveshjen, me akt të njëanshëm duke dhënë 30 (tridhjetë) ditë afat me njoftim paraprak (arsyetim), në formë të shkruar palës tjetër.

Neni 10
Kopjet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe, në katër (4) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga dy (2) kopje.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Besian MUSTAFA
Ministër në detyrë i MBRZhR-së



Ardian GJINI
Kryetar i Komunës së Gjakovës

